

VENDIM
Nr.786, datë 22.7.2009

PËR NGRITJEN DHE ORGANIZIMIN E STACIONIT TË POLICISË SË MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMI NË TUNELIN THIRRË-KALIMASH

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.8766, datë 5.4.2001 “Për mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin”, të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të ligjit nr.10 025, datë 27.11.2008 “Për buxhetin e vitit 2009”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në tunelin Thirrë-Kalimash, në anën, që lidhet me qytetin e Kukësit, të ngrihet stacioni i policisë së mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit, si pjesë e sistemit të Drejtorisë së Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit (PMNZSH).

2. Emërimi, titullimi, transferimi dhe lirimi nga detyra e oficerit të stacionit të PMNZSH-së në këtë objekt të bëhen nga Ministri i Brendshëm.

3. Plotësimi me personel shërbimi i këtij stacioni të bëhet nga prefekti i qarkut, me propozimin e shefit të stacionit të PMNZSH-së së objektit, në përputhje me kriteret e përcaktuara në ligjin nr.8766, datë 5.4.2001 “Për mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin” dhe me aktet e tjera nënligjore, dalë në zbatim të tij.

4. Organizimi, drejtimi dhe formimi profesional i personelit të këtij stacioni të bëhen nga shefi i PMNZSH-së së objektit dhe të kontrollohen nga drejtoria e PMNZSH-së.

5. Efekti financiar për ngritjen dhe funksionimin e stacionit të PMNZSH-së, përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi arrin vlerën 10 612 000 (dhjetë milionë e gjashtëqind e dymbëdhjetë mijë) lekë, për shpenzime personeli.

6. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit.

7. Ngarkohen Ministri i Brendshëm dhe Ministri i Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha